



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:232567
Datë: 07.05.2024
Numri i dokumentit: 05659409

C.nr.3548/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Gj.B. me numër personal I.R.1. me numër personal I.R.2. me numër personal K.K. me numër personal dhe L.K. me numër personal që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av. A.H. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, të cilën e përfaqëson V.I.Xh. nga Prizreni, me objekt të kontestit kompensimi i shujtave ditore, vlera e kontestit 1,200.00 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 07.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësve: Gj.B., I.R.1., I.R.2., K.K. dhe L.K. që të gjithë nga Prizreni.

II. DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, që paditësve në emër të shujtave ditore, t'ia paguaj shumat si në vijim:

- Paditësit Gj.B. në emër të shujtave ditore, për 117 ditë pune për vitin 2020 (nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2020), t'i paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë apo shumën prej 234.00 euro dhe për 120 ditë pune për vitin 2022 (nga data 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022), t'i paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë apo shumën prej 240.00 euro apo shumën e përgjithshme prej 474.00 euro.
- Paditësit I.R.1., në emër të shujtave ditore për 120 ditë pune për vitin 2022 (nga data 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022), t'i paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë apo shumën e përgjithshme prej 240.00 euro.
- Paditëses I.R.2., në emër të shujtave ditore për 120 ditë pune për vitin 2022 (nga data 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022), t'i paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë apo shumën e përgjithshme prej 240.00 euro.
- Paditëses K.K. në emër të shujtave ditore për 120 ditë pune për vitin 2022 (nga data 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022), t'i paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë apo shumën e përgjithshme prej 240.00 euro.
- Paditëses L.K. në emër të shujtave ditore për 120 ditë pune për vitin 2022 (nga data 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022), t'i paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë apo shumën e përgjithshme prej 240.00 euro.

Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, për secilin paditës, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë më datë 31.10.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që paditësve, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 342.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit Gj.B., I.R.1., I.R.2., K.K. dhe L.K. që të gjithë nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tyre av. A.H. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, të cilën e përfaqëson V.I.Xh. nga Prizreni, për shkak të kompensimit të shujtave ditore, vlera e kontestit 1,434.00 euro.

Në padi, ka theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune pranë ShMLM "Lorenc Antoni" në Prizren. Paditësi Gj.B. pranë të paditurës ka qenë në punë në 117 ditë pune gjatë vitit 2020, për periudhën kohore nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2020 dhe në 120 ditë pune gjatë tërë vitit 2022, për periudhën kohore nga data 01.01.2022 deri më 20.11.2022. Paditësi I.R.1. pranë të paditurës ka qenë në punë në 117 ditë pune gjatë tërë vitit 2022, për periudhën kohore nga data 01.01.2022 deri më 20.11.2022. Paditësja I.R.2. pranë të paditurës ka qenë në punë në 117 ditë pune gjatë tërë vitit 2022, për periudhën kohore nga data 01.01.2022 deri më 20.11.2022. Paditësja K.K. pranë të paditurës ka qenë në punë në 117 ditë pune gjatë tërë vitit 2022, për periudhën kohore nga data 01.01.2022 deri më 20.11.2022. Paditësja L.K. pranë të paditurës ka qenë në punë në 117 ditë pune gjatë tërë vitit 2022, për periudhën kohore nga data 01.01.2022 deri më 20.11.2022.

E paditura, përmes përfaqësueses ligjore, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, lidhur me kompensimin e shujtës ditore. Ka theksuar se bazuar në njoftimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me numër 01B/488, të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadija e paditësve është e pabazuar. Po ashtu sipas të autorizuarës së të paditurës përfitues të benificioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësi nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtarë i sindikatës. Po ashtu ka theksuar se të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësit është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e saj. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditësve është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas vërtetimit të prezencës në punë lëshuar nga ShMLM "Lorenc Antoni" në Prizren, me numër reference 09-28/2021 i datës 18.01.2021, vërtetohet se paditësi Gj.B. për vitin 2020, ka realizuar gjithsej 120 ditë pune. Po ashtu, sipas vërtetimit me numër reference 145/22/2023 i datës 20.09.2023, vërtetohet se paditësi Gjilian Bytyqi për vitin 2022, ka realizuar gjithsej 120 ditë pune.

Sipas vërtetimit të prezencës në punë lëshuar nga ShMLM “Lorenc Antoni” në Prizren, me numër reference 145/23/2023 i datës 20.09.2023, vërtetohet se paditësi I.R.1. për vitin 2022, ka realizuar gjithsej 120 ditë pune.

Sipas vërtetimit të prezencës në punë lëshuar nga ShMLM “Lorenc Antoni” në Prizren, me numër reference 145/24/2023 i datës 20.09.2023, vërtetohet se paditësja I.R.2. për vitin 2022, ka realizuar gjithsej 120 ditë pune.

Sipas vërtetimit të prezencës në punë lëshuar nga ShMLM “Lorenc Antoni” në Prizren, me numër reference 145/25/2023 i datës 20.09.2023, vërtetohet se paditësja K.K. për vitin 2022, ka realizuar gjithsej 120 ditë pune.

Sipas vërtetimit të prezencës në punë lëshuar nga ShMLM “Lorenc Antoni” në Prizren, me numër reference 145/27/2023 i datës 20.09.2023, vërtetohet se paditësja L.K. për vitin 2022, ka realizuar gjithsej 120 ditë pune.

Vërtetimet e lartcekur, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, në të cilën dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Andaj pasi këto vërtetime janë lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilët si të tillë janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimeve të ShMLM “Lorenc Antoni” në Prizren, gjykata ia fali besimin e plotë, si provë me të cilat vërtetohet fakti lidhur me ditët e punës, konkretisht paditësi Gj.B. për vitin 2020 ka punuar 117 ditë dhe për vitin 2022 ka punuar 120 ditë, paditësi I.R.1. për vitin 2022 ka punuar 120 ditë, paditësja I.R.2., për vitin 2022 ka punuar 120 ditë, paditësja K.K. për vitin 2022 ka punuar 120 ditë dhe paditësja L.K. për vitin 2022 ka punuar 120 ditë.

Bazuar në faktet e çështjes, gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë me numër protokolli 2056 e datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë me numër 01/B, numër të protokolli 105 e datës 22.01.2021.

Me nenin 35 par. 7 të Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë të cekura më lartë, është përcaktuar e drejta e punëtorëve në kompensimin e shujtave dhe atë “të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësve si punëtorë të arsimit, t’ia paguaj kompensimin për shujtat ditore, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontratat Kolektive të Arsimit, në kuptim të nenit 55 par. 1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Nga gjendja faktike e vërtetuar, rezultoi se e paditura ka detyrimin e pagesës në emër të ushqimit në punë, ngase përmes vërtetimit të prezencës në punë është vërtetuar se paditësi Gj.B. për vitin 2020, nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2020, ka punuar 117 ditë pune dhe për vitin 2022, nga data 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022, ka punuar 120 ditë pune, e që në rastin konkret të njëjtit i takon shuma prej 474.00 euro e cila është llogaritur duke e shumëzuar numrin e ditëve të punës 237 me 2 euro (237 x 2 euro = 474.00 euro), paditësi I.R.1. për vitin 2022, nga data 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022, ka punuar 120 ditë pune, e që në rastin konkret të njëjtit i takon shuma prej 240.00 euro e cila është llogaritur duke e shumëzuar numrin e ditëve të punës 120 me 2 euro (120 x 2 euro = 240.00 euro), paditësja I.R.2. për vitin 2022, nga data 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022, ka punuar 120 ditë

pune, e që në rastin konkret të njëjtës i takon shuma prej 240.00 euro e cila është llogaritur duke e shumëzuar numrin e ditëve të punës 120 me 2 euro (120 x 2 euro = 240.00 euro), paditësja K.K. për vitin 2022, nga data 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022, ka punuar 120 ditë pune, e që në rastin konkret të njëjtës i takon shuma prej 240.00 euro e cila është llogaritur duke e shumëzuar numrin e ditëve të punës 120 me 2 euro (120 x 2 euro = 240.00 euro) dhe paditësja L.K. për vitin 2022, nga data 01.01.2022 deri më datë 20.11.2022, ka punuar 120 ditë pune, e që në rastin konkret të njëjtës i takon shuma prej 240.00 euro e cila është llogaritur duke e shumëzuar numrin e ditëve të punës 120 me 2 euro (120 x 2 euro = 240.00 euro).

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (31.10.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Andaj, bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësve është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës me përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 312.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 30.00 euro, përkatësisht në shumën e përgjithshme 342.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitën e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.3548/2023, datë 07.05.2023

Gjyqtari,
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

Numri i lëndës: 2023:232567
Datë: 07.05.2024
Numri i dokumentit: 05659409